

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Edhe një herë për deputetin analfabet dhe “mbështetësit” e tij
ADRESA	https://www.cna.al/editorial/edhe-nje-here-per-deputetin-analfabet-dhe-mbeshtetesis-e-tij-i474130
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 14:52:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:28:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d38433dac06c96ddad11cb7936f5329f9dd8c6e78e1a04f5f23b8c1b7b5dfc3b
TEKSTI	a667dc2495feb07f8e1cc0f0ed3e931401ea299a79041c109cddd0b256c30439
PAMJA	24038e3808f2e5d8007b85e6cff0994ffec792c8f54e27ef9438a3d709c34bb9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a798e186f9f3fddce8abd8fdc2948288298c21adaa5c515e1faa9b9ff20b1b0a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e0b9829abbee6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67ff94e9a06c82fe2c5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a798e186f9f3fddce8abd8fdc2948288298c21adaa5c515e1faa9b9ff20b1b0a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

16:28 Editorial Elvi FUNDO

Shembulli i analfabetizmit i mbështetur nga bandat, krimi ...

Edhe një herë për deputetin analfabet dhe “mbështetësit” e tij



14 Shtator 2026, 16:28, Editorial Elvi FUNDO



Shembulli i analfabetizmit i mbështetur nga bandat, krimi dhe droga. Ky është deputeti Fidel Kreka.

Në Korçë ta thonë të gjithë, edhe ata që e mbrojnë, por kanë një argument: "Është demokrat, është djali i Arturit, le të jetë analfabet. Shikoni Kuvendin, mos shikoni deputetin tonë".

Nuk mund të ketë dy fytyra, pra një PD, e cila kërkon që kundërshtari i saj të mos vjedhë votat, të mos lidhet me krimin, të mos lidhet me drogën dhe nga ana tjetër përdor injorantë e analfabetë për t'i bërë deputetë, duke i mbështetur krimi, droga apo lloj-lloj skenarësh. Pa folur që vetë Fidel Kreka është një njeri me precedentë penalë. Ne nxorëm vetëm 3 raste, ka edhe 30 të tjera po të duan.



Kush është deputeti i bandave, drogës, fajdeve dhe krimeve në Korçë?

Thelbi i çështjes është një dhe vetëm një: a mund të ringrihet Partia Demokratike me të tilla personazhe?

Nuk ka asnjë kundërshtim që është militant, është demokrat. Shumë mirë, të qëndrojnë në vendin që i takon. Por një Parti Demokratike e fortë, për të ardhur në pushtet, nuk mund të ripërtërihet nga një qelizë sharlatanësh, nga një qelizë pijanecësh, qelizë përdoruesish të lëndëve narkotike, qelizë rrugaçësh në "Radenec".

Nuk mundet.

Në atë lagje mund të ketë djem dhe vajza shumë të mira, pa asnjë diskutim. ***Por Partia Demokratike nuk mund të ripërtërihet vetëm nga një qelizë horrash atje.***

A mundet Partia Demokratike të ripërtërihet dhe të marrë vlera e vota, kur në qytetin e Korçës nuk ka fituar asnjë qendër votimi me këtë Fidel Krekën kandidat në listë të hapur?

A mundet të fitojë Partia Demokratike kur është 10.000 vota pas Partisë Socialiste dhe shpall fitoren Fidel Kreka?

Ai tha se fitoi betejën e madhe në Korçë, ndërkohë që PD-ja është në opozitë e ka vetëm 4 mandate dhe ka 10.000 vota më pak se në ditën kur ka dalë në opozitë, sesa në vitin 2013. 10 mijë vota më pak.



Deputetin e krimit dhe drogës e nxorri aleanca Rama-Salianji-Ylli

Unë i kam shtruar disa pyetje, nuk morën përgjigje. As për lidhjet, as për financimet, as për problematikat e tij penale.

Filluan sulmet. Një tufë të marrësh, me sulmin "obobo, pse po preket Fidel se është djali i Turit". Edhe një herë: Tjetër Artur Kreka, tjetër Fidel Kreka. Arturi ishte militant, demokrat, por nuk shkoi të bëhej deputet. Dhe mendoj që po të kishte qenë gjallë, i ndjeri nuk do ta kishte lënë të birin të bëhej deputet, sepse ai e njihte djalin e tij, që nuk kalonte dot klasën e katërt fillore.

Pra, në këtë kuptim, s'ka asnjë lidhje Artur Kreka me Fidel Krekën.

E dyta, sulmet nuk janë zgjidhje e problemit, por e vërteta e prekshme.

Problemi në Korçë është se ka një Parti Demokratike që nuk bën zgjidhje dhe ditën e votimit, Fidel Kreka, me disa përdorues të lëndëve narkotike dhe persona me precedentë penalë, kanë shkuar dhe kanë prishur procesin zgjedhor.



Njerëzit e Salianjit dhe Krekës prishën procesin zgjedhor/ Shtyhet votimi për kreun e PD-së në Korçë

Thelbi i problemit qëndron në faktin që Ivi Kaso nuk e menaxhon dot degën e PD-së së Korçës, por shkon e trembet dhe zbythet nga elementë të grupeve kriminale dhe nuk i jep drejtim degës në Korçë, nuk zhvillon dot zgjedhje. Sepse e ka marrë peng Fidelin.

Më tej, problemi qëndron te fakti që u mblodhën Ledina, Salianji e Fideli dhe nxorën deputetët e fundit, duke ngritur tezën me të pështirë se janë myslimanë, shumicë, "do ta drejtojmë ne". Po ç'lidhje ka besimi fetar në një forcë politike?



Kriminale/ Salianji ndez ndarjen fetare në Korçë

Një forcë politike është një grup vullnetarësh, me disa rregulla të mirëpërcaktuara, ku shumicën e bën vota dhe duhet të ketë kritere të mirëfillta e të forta për ata që hyjnë të votohen. Pasi për mendimin tim, Fidel Kreka s'duhet të ishte fare në atë listë kandidatësh për deputet, se nuk plotëson asnjë kriter politik, përveç faktit se është një militant me precedentë penalë, por quhen këto? Mund të jetë një djallë shumë i mirë për shoqërinë, për mëhallën, mund të jetë bamirës, Zoti ia ktheftë me të mira.

Por s'mund ta përdorësh fenë, apo t'i përdorësh ata e disa të tjerë në mënyrën më të ndyrë dhe të pështirë, duke thënë "po e sulmojnë se është mysliman". Tezë tjetër e disa budallenjve të pajustificueshëm edhe kjo.

Kështu tha edhe një tjetër budalla i keqpërdorur që donte të kandidonte për kryetar dhe thoshte "s'më lanë se jam mysliman".



E vërteta pse nuk kandidoi në Korçë kandidati i "Babales"

Turpi i turpeve!

Kur PD-ja ka pasur shumicën e kryetarëve të saj myslimanë s'ka pasur asnjë problem. Kur kryetari i PD-së, Sekretari i Përgjithshëm e me radhë e hoqën ata për kryetar? Dhe këtë po e sulmojnë tani se është mysliman. Pra, kur nuk kanë çfarë të thonë, nuk kanë çfarë t'u përgjigjen akuzave që u bëhen, fshihen si maskarenj pas tezave fetare. Jo! Fidel Kreka nuk është sulmuar se është mysliman, Fidel Kreka është sulmuar sepse është një analfabet dhe injorant i mbështetur nga krimi dhe droga.



Si e masakroi PD-në deputeti i mbështetur nga krimi dhe droga

Dhe imagjinoni... Korça të përfaqësohet nga Fidel Kreka!

Mund ta duan disa demokratë, disa myslimanë apo militantë, por jo, nuk mjaftojnë. Ka plot djem e vajza të shkolluara e edukuara, myslimanë, që mund të përfaqësojnë Korçën e të shkojnë në parlament, që dinë të bëjnë një ligj, të lexojnë, të mbrojnë interesat e qytetit me vlera intelektuale.

Pyetja lind se çfarë di të lexojë Fidel? Di të lexojë ligje? Di të përgatisë ligje? Di të kundërshtojë, të debatojë problematikën e një diskutimi në një komision parlamentar? Apo thjesht të ngrejë dorën?! Kështu e ngre edhe gomari këmbën kur e mësojnë, ky s'ka mësuar kurrë.

Prandaj, për të gjithë ata që nuk e dinë ose nuk duan ta kuptojnë, e vërteta është një dhe vetëm një: ata po i shërbejnë në mënyrën më spektakolare PS-së dhe Niko Peleshit.



Deputeti i mbështetur nga krimi dhe droga ka skedë kriminale

PD nuk fiton dot zgjedhjet në Qarkun Korçë me një qendër votimi në "Radenec" apo me 50 veta që i vijnë vërdallë Fidelit. Sepse nuk të vijnë vlerat qytetare dhe intelektuale, qofshin dhe ata myslimanë në qoftë se i doni, meqenëse ortodoksët qenkan pakicë dhe duhet ta marrin myslimanët.

Patjetër, le ta marrin! Le të jetë kryetari i PD-së mysliman, nuk ka asgjë të keqe, ka pasur gjithmonë.

Po duhet të jetë një qytetar, një njeri me vlera, të bashkojë, jo ta përdorë fenë për përçarje, për t'u fshehur, për t'u mbrojtur kur vjen nga problematikat ligjore, nga analfabetizmi, nga injoranca dhe shkon e strehohet te feja.

Shkon e strehohet te babi! Bën dhe trimin: "Këtu jam unë te PD-ja, ja do ta shikojmë!"

Çfarë të shikojnë njerëzit, more? Po ju kanë parë, more, ju di një Korçë e tërë!

Edhe këta mjeranët e tjerë që komentojnë, po nuk fiton Partia Demokratike me një qendër votimi në "Radenec"! Nuk e kuptoni këtë gjë?

Nuk fiton Partia Demokratike duke nxitur ndarje fetare edhe koncepte fetariste sektariste. Nuk fiton Partia Demokratike po nuk vajtët te vlerat qytetare, intelektuale. Nuk fiton Partia Demokratike po nuk u hap gara, po nuk u vu një kryetar përfaqësues i qytetit, që të gjithë, edhe kundërshtarët në mënyrë të veçantë, dinë të thonë një fjalë të mirë, dinë ta vlerësojnë.



Edhe njëherë për deputetin e mbështetur nga krimi dhe droga, analfabetin dhe injorantin politik

Kush do ta bëjë PD-në, servilizmi apo hipokrizia?

Ata që shkruajnë në komente "Rroftë Fidel!" dhe më shkruajnë mua "ai është kështu, ai është ashtu, se ti s'di asgjë, ai i ka bërë të gjitha këto, i ka bërë dhe ato, po ne çfarë t'i bëjmë sa të kemi, se është demokrat, se është militant, se është djali i Arturit".

Edhe një herë: nuk është sulmuar ndaj Fidel Krekës se është djali i Artur Krekës, aspak. As se është mik i Salianjit, aspak. As se fitoi, të fitojë e ta gëzojë, s'i prish punë kujt fitorja e tij deri këtu, po stop! Këtu mbaron historia.

Fajin nuk e ka ai, fajin e kanë ata që e vunë në listë. Fidel Kreka është një militant rrugaç si ata shumë të tjerë, që ka bërë ca shkollë pa shkuar në shkollë, siç thashë edhe më lart, që s'di as emrat e profesorëve apo pedagogëve, dhe kaq. Por nuk është për deputet!

Edhe këtë e lëngon PD-ja, që është në kuotat më të ulëta në historinë e Korçës.



FAKTET/ Ja deputeti analfabet, Kuvendi duhet të hapë kurs gjuhe

Ndaj shikojeni të vërtetën në sy!

Lëreni besimin islam, lëreni të ndjerin Artur Kreka, po shikoni se ju ka marrë lumi dhe po mbyteni duke e çuar në një rrugë pa kthim edhe PD-në!

Nuk mundet një qelizë, po e përsëris, në një lagje, në një qendër votimi, të rrëmbejë një forcë politike, ta marrë peng, të mos zhvillojë zgjedhje, të përplasen duke përdorur sa emrin e një të ndjeri dhe sa besimin fetar.



Me fakte dhe prova/ Deputeti analfabet që mbështetet nga krimi dhe droga në Korçë

Kështu Partia Demokratike nuk ka për t'u bërë kurrë!

Me Fidelin, dhe me ca nga ata që ka nga pas, dhe me tezat që përdorin, nuk ka për të fituar kurrë! Por është thjesht dhe vetëm duke i bërë një shërbim të pandalshëm Niko Peleshit. Ai fiton! Nga zgjedhjet, konfliktet, sharjet dhe veprimet e Fidel Krekës dhe zareve të tij, disa prej të cilëve fatkeqësisht e quajnë veten burra, megjithëse vështirë të kenë dy "r".

Vlerat dhe parimet në një forcë politike me rregulla, për të nxjerrë kandidatët më të shkëlqyer, me qëllim që të "thithin" votat e qytetarisë, të çdo besimi fetar, janë rruga drejt një fitoreje. Kurse kjo që bëjnë këta, është thjesht ndarje dhe të investosh për të qëndruar pambarimisht në opozitë dhe t'i shërbesh pa pushim Ramës, Peleshit e CO./ **CNA**


- Me fakte dhe prova/ Deputeti analfabet që mbështetet nga krimi dhe droga në Korçë
- Edhe njëherë për deputetin e mbështetur nga krimi dhe droga, analfabetin dhe injorantin politik
- Deputeti i mbështetur nga krimi dhe droga ka skedë kriminale
- Si e masakroi PD-në deputeti i mbështetur nga krimi dhe droga
- Deputetin e krimit dhe drogës e nxorri aleanca Rama-Salianji-Ylli

- Kush është deputeti i bandave, drogës, fajdeve dhe krimeve në Korçë?



- FAKTET/ Ja deputeti analfabet, Kuvendi duhet të hapë kurs gjuhe





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.